

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësia Org.
 Org. Jedinica
 Org. Unit

KM-MIT

Nr. i Prot.
 Broj Prot.
 Prot. No.

204/19

Data:
 Datum:
 Date:

19.04.19

Nr. i Faqeve
 Br. Stranica
 No. Pages

2

PRISHTINE/A



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësia Org.
 Org. Jedinica
 Org. Unit

01

Nr. i Prot.
 Broj Prot.
 Prot. No.

444

Data:
 Datum:
 Date:

19.04.19

Nr. i Faqeve
 Br. Stranica
 No. Pages

01

PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

I. Refuzohet kërkesa nr.2129 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus N.T.SH. "Berisha Impex" me seli në Istog për marrjen e nisjes në relacionin Pejë-Gurakoc-Istog dhe anasjelltas me orare të nisjes (14:15 - 15:15) .

Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus N.T.SH. "Berisha Impex" me seli në Istog **nuk ka plotësuar** kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A

nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjes në relacionin Pejë-Gurakoc-Istog dhe anasjelltas me orare të nisjes (14:15 - 15:15) pasi që referuar evidencave zyrtare që posedon Departamenti i Transportit Tokësor operatori në fjalë posedon 13 (trembëdhjetë) rende të udhëtimit valide për operim në transportin ndërurban andaj në bazë të kapaciteteve që disponon nuk mundet të mbulojë nisje të tjera respektivisht nuk posedon kapacitetet teknike të mjaftueshme për marrjen e nisjeve të reja.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

Pal LEKAJ

Ministër



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.